REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 345, Datë 06.11.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADIMINISTRATIVE PËR MIRATIMIN E "RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT DHE TË PËRZGJEDHJES SË FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT"

Në mbështetje të neneve 16, 109, pika 2, 110 dhe 134 pika 4, të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", si dhe neneve 15 dhe 26 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2026, pasi shqyrtoi relacionin nr. 3491 prot., datë 05.11.2026 të përgatitur nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të ERE-s nr. 138, datë 18.08.2026, "*Mbi fillimin e procedurës administrative për miratimin e Rregullores për përcaktimin e kritereve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së Furnizuesit të Mundësisë së Fundit*",

Konstatoi se:

- Neni 109 i ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", në pikën 1 parashikon furnizimin e mundësisë së fundit për klientët që mbeten pa furnizues në rastet e përcaktuara në këtë dispozitë, përfshirë rastet kur furnizuesi i mëparshëm nuk mund të vijojë furnizimin ose kur klienti nuk arrin të gjejë një furnizues në treg, ndërsa në pikën 2 përcakton kompetencën e ERE-s për miratimin e rregullores që përfshin kriteret e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit (FMF), detyrimet e tij, transferimin e klientëve drejt dhe nga ky furnizues, si dhe të drejtat e klientëve fundorë për t'u furnizuar nga FMF-ja.
- Neni 110, pika 1, i ligjit nr. 59/2026 parashikon miratimin nga Këshilli i Ministrave të kushteve dhe procedurave për caktimin e FMF-së, bazuar në kritere konkurruese, transparente dhe jodiskriminuese. Pika 2 e këtij neni përcakton caktimin e FMF-së nga ERE për një periudhë trevjeçare, ndërsa pikat 3 dhe 4 parashikojnë përmbajtjen e vendimit të caktimit të FMF-së dhe përcaktimin e çmimit të furnizimit sipas metodologjisë përkatëse.
- Neni 134, pikat 1 dhe 4, i ligjit nr. 59/2026 parashikon miratimin, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të akteve nënligjore përkatëse nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të nenit 110, pika 1, dhe nga ERE, në zbatim të nenit 109, pika 2, të këtij ligji.
- Rregullorja ekzistuese për përcaktimin e kritereve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit është miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 141, datë 15.06.2021, në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", të ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 449, datë 15.06.2016. Me miratimin e ligjit nr. 59/2026, vlerësohet i nevojshëm rishikimi dhe harmonizimi i kuadrit rregullator për përzgjedhjen e FMF-së, duke marrë në konsideratë edhe dispozitat kalimtare dhe shfuqizuese të neneve 135 dhe 136 të këtij ligji.
- Në zbatim të ligjit nr. 59/2026 dhe Urdhrit të Kryetarit të ERE-s nr. 138, datë 18.08.2026, Grupi i Punës ka hartuar projekt-rregulloren "*Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit*", me qëllim përcaktimin e rregullave për vlerësimin e

aplikimeve, dokumentacionin përkatës, fazat procedurale dhe përgatitjen e propozimit për vendimmarrje nga bordi i ERE-s, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 59/2026.

- Projekt-rregullorja parashikon rregulla për organizimin e procedurës së përzgjedhjes së FMF-së, shpalljen e ftesës për aplikim, paraqitjen dhe shqyrtimin e aplikimeve, si dhe vlerësimin e dokumentacionit dhe të ofertave, duke respektuar parimet e transparencës, proporcionalitetit, konkurrencës dhe mosdiskriminimit. Gjithashtu, parashikohet dokumentimi i procesit të vlerësimit dhe përgatitja e raportit përkatës për vendimmarrje nga bordi i ERE-s.
- Në lidhje me kriteret e vlerësimit, projekt-rregullorja trajton licencimin në veprimtarinë e furnizimit, kapacitetet teknike dhe njerëzore, qëndrueshmërinë financiare, përvojën, sistemet e faturimit dhe administrimit të klientëve, si dhe elementet ekonomike të ofertës. Përcaktimi dhe zbatimi i kërkesave specifike për përvojën minimale, garancitë, pikëzimin dhe trajtimin e ofertave me rezultate të barabarta duhet të bëhen në përputhje me kushtet dhe procedurat që miratohen nga Këshilli i Ministrave, sipas nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 59/2026.
- Projekt-rregullorja përfshin parashikime për detyrimet e FMF-së gjatë ushtrimit të shërbimit, veçanërisht për informimin e klientëve, vazhdimësinë e furnizimit, koordinimin me operatorët e sistemit, transferimin e klientëve drejt dhe nga FMF-ja, si dhe të drejtën e tyre për të zgjedhur një furnizues tjetër. Gjithashtu, trajtohen monitorimi i përmbushjes së detyrimeve nga ERE dhe mekanizmat e ankimit.
- Projekt-rregullorja përmban 14 nene dhe dy anekse, të cilat trajtojnë organizimin e procedurës, kriteret e vlerësimit, përgatitjen e raportit të vlerësimit, detyrimet e furnizuesit të mundësisë së fundit, transferimin e klientëve, monitorimin dhe ankimin. Aneksi 1 përmban modelin e ftesës për aplikim, ndërsa Aneksi 2 trajton dokumentimin e ofertave me rezultate të barabarta.
- Duke qenë se neni 110, pika 1, i ligjit nr. 59/2026 parashikon miratimin nga Këshilli i Ministrave të kushteve dhe procedurave për caktimin e FMF-së, gjatë shqyrtimit të projekt-rregullores duhet të sigurohet përputhshmëria e dispozitave të saj me aktin përkatës të Këshillit të Ministrave, me qëllim respektimin e ndarjes së kompetencave të përcaktuara në ligj.
- Përpara miratimit përfundimtar, projekt-rregullorja duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e ERE-s, me qëllim marrjen dhe shqyrtimin e komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve të furnizuesve të licencuar të energjisë elektrike, operatorëve të sistemit dhe palëve të tjera të interesuara. Gjatë këtij procesi do të vlerësohen në mënyrë të veçantë kriteret e vlerësimit, fazat procedurale, dokumentacioni i kërkuar dhe përputhshmëria e tyre me aktin përkatës të Këshillit të Ministrave.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për miratimin e "*Rregullores për përcaktimin e kritereve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit*", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Projekt-rregullorja *Për përcaktimin e kritereve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit* t'i nënshtrohet procedurës së konsultimit dhe shqyrtimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe procedurat e përcaktuara nga ERE për miratimin e akteve rregullatore.

3. Ngarkohet Grupi i Punës për ndjekjen e procedurës, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale lidhur me publikimin dhe konsultimin e projektaktit, administrimin dhe shqyrtimin e komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura, si dhe organizimin e seancave dëgjimore, sipas nevojës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 345, datë 06.11.2026

Projekt-RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT DHE TË PËRZGJEDHJES SË FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton kriteret e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit (FMF), dokumentacionin dhe mënyrën e shqyrtimit të aplikimeve, detyrimet e FMF-së, transferimin e klientëve drejt dhe nga FMF-ja, si dhe të drejtat e klientëve fundorë për këtë shërbim, në përputhje me ligjin nr. 59/2026 dhe kushtet e procedurat e miratuara nga Këshilli i Ministrave.

2. Rregullorja miratohet në zbatim të nenit 109, pika 2, dhe nenit 134, pika 4, të ligjit nr. 59/2026, duke respektuar nenin 110 dhe vendimin e Këshillit të Ministrave që miratohet sipas nenit 110, pika 1, dhe nenit 134, pika 1.

3. Në rast mospërputhjeje, zbatohen dispozitat e ligjit dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave për caktimin e FMF-së.

4. Qëllimi i rregullores është përzgjedhja e një furnizuesi që provon aftësinë për të marrë përsipër shërbimin e mundësisë së fundit dhe garantimi i vazhdimësisë së furnizimit e i të drejtave të klientëve gjatë kalimit në këtë shërbim dhe daljes prej tij.

Neni 2

Përkufizime

1. “VKM-ja për FMF-në” është vendimi i Këshillit të Ministrave që miratohet në zbatim të nenit 110, pika 1, dhe nenit 134, pika 1, të ligjit nr. 59/2026, për kushtet dhe procedurat e caktimit të FMF-së.

2. “Komisioni” është struktura e ngritur nga Kryetari i ERE-s për administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e aplikimeve në procedurën konkurruese të administruar nga ERE, në përputhje me VKM-në për FMF-në.

3. Termat, përkufizimet e të cilëve nuk renditen në këtë nen, kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. “Aplikim” është dosja e pjesëmarrjes në procedurë, e cila përmban dokumentacionin provues dhe ofertën e aplikuesit. “Ofertë” është propozimi teknik dhe ekonomik për kryerjen e shërbimit, sipas dokumenteve të konkurrimit.

Neni 3

Kuadri i caktimit të FMF-së

1. FMF caktohet nga ERE, në përputhje me nenin 110, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, në bazë të kushteve dhe procedurave që miratohen nga Këshilli i Ministrave sipas nenit 110, pika 1. Përcaktimi i FMF bëhet për tre vjet, sipas nenit 110, pika 3, të ligjit nr. 59/2026.

2. Vendimi i ERE-s për caktimin e FMF-së përmban kushtet e shërbimit, informacionin për përcaktimin e çmimeve dhe ndryshimet e tyre, si dhe kushtet kontraktore, sipas nenit 110, pika 3.

3. FMF furnizon klientët që mbeten pa furnizues kur furnizuesi i mëparshëm është në paaftësi paguese ose në proces falimentimi, kur licenca e tij hiqet ose pezullohet përkohësisht, apo kur klienti nuk arrin të gjejë furnizues në treg, sipas nenit 109, pika 1, të ligjit.

4. Periudha trevjeçare e caktimit të FMF-së nuk përbën afatin e furnizimit të secilit klient. Kohëzgjatja e furnizimit të klientit zbatohet sipas ligjit dhe akteve që rregullojnë shërbimin e mundësisë së fundit dhe i bëhet e njohur klientit në njoftimin e kalimit.

Neni 4

Fillimi i procedurës

1. ERE organizon procedurën e përzgjedhjes dhe cakton FMF-në sipas nenit 110, pika 2, duke zbatuar kushtet dhe procedurat e VKM-së që miratohet në zbatim të nenit 110, pika 1.

2. Për procedurën konkurruese të administruar nga ERE, Kryetari ngre komisionin për administrimin dhe vlerësimin e aplikimeve. Akti i ngritjes përcakton përbërjen, kryesimin, sekretarinë, detyrat dhe mënyrën e dokumentimit të punës, në përputhje me VKM-në për FMF-në.

3. Anëtarët e komisionit deklarojnë konfliktet e interesit dhe përjashtohen nga shqyrtimi në rastet e parashikuara nga legjislacioni përkatës.

4. Bordi i ERE-s vendos fillimin e procedurës dhe miraton ftesën e dokumentet e konkurrimit, në përputhje me VKM-në për FMF-në. Vendimi identifikon shtrirjen e shërbimit, kalendarin e procedurës dhe datën e parashikuar të marrjes së shërbimit. Përgatitja e procedurës së re planifikohet jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të periudhës së caktimit të FMF-së ekzistuese.

Neni 5

Fazat e procedurës

1. Procedura konkurruese e administruar nga ERE përfshin: vendimin e fillimit dhe miratimin e dokumenteve; shpalljen e ftesës dhe dhënien e sqarimeve; pranimin, regjistrimin dhe hapjen e aplikimeve; verifikimin e dokumentacionit dhe kualifikimin; vlerësimin dhe renditjen e ofertave; raportin e komisionit; vendimmarrjen e Bordit; njoftimin e vendimit dhe publikimin e rezultatit; marrjen e shërbimit nga FMF-ja e caktuar.

2. Afatet dhe mënyra e zhvillimit të fazave pasqyrohen në dokumentet e konkurrimit, në zbatim të VKM-së për FMF-në. Për çdo fazë identifikohen struktura përgjegjëse, veprimet që kryhen dhe dokumenti që provon përfundimin e saj.

Neni 6

Shpallja dhe dokumentet e konkurrimit

1. Ftesa publikohet sipas mënyrës dhe afateve të VKM-së për FMF-në.

2. Ftesa përmban bazën ligjore, subjektet e pranueshme, dokumentacionin, kriteret e kualifikimit dhe vlerësimit, afatet, adresën e dorëzimit, mënyrën e kërkimit të sqarimeve dhe mjetet e ankimit.

3. Kriteret e kualifikimit, kriteret e vlerësimit, formulat e pikëzimit dhe mënyra e zgjidhjes së barazimit publikohen me dokumentet e konkurrimit.

4. Kërkesat për sqarime paraqiten me shkrim apo në adresën elektronike të paracaktuar nga Komisioni, brenda afatit të parashikuar në ftesë. ERE publikon përgjigjet në të njëjtin vend ku janë publikuar dokumentet e konkurrimit, pa identifikuar kërkuesin dhe duke ua vënë në dispozicion të gjithë pjesëmarrësve njëkohësisht.

5. Çdo korrigjim i dokumenteve përpara përfundimit të afatit të dorëzimit miratohet dhe publikohet sipas procedurës së zbatueshme. Kur korrigjimi ndikon në përgatitjen e aplikimeve, afati rishikohet në përputhje me VKM-në për FMF-në dhe Kodin e Procedurave Administrative, për t'u dhënë pjesëmarrësve kohë për përshtatjen e tyre.

Neni 7

Paraqitja e aplikimeve

1. Aplikimi nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor ose përfaqësuesi i autorizuar i subjektit.

2. Dokumentet dorëzohen në gjuhën shqipe ose të shoqëruara me përkthimin përkatës, sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkesave të ftesës.

3. Mënyra e dorëzimit, afati, vlefshmëria e ofertës, plotësimi i mangësive dhe pasojat e dorëzimit të vonuar zbatohen sipas VKM-së për FMF-në dhe dokumenteve të konkurrimit.

4. Çdo aplikim regjistrohet me datën dhe orën e marrjes dhe ruhet pa u hapur deri në momentin e përcaktuar në dokumentet e konkurrimit. Hapja dokumentohet në procesverbal, ku shënohen aplikuesit, dokumentet e administruara dhe çdo parregullsi e konstatuar. Aplikimet e vonuara evidentohen veçmas dhe trajtohen sipas rregullit të shpallur në ftesë.

5. Kërkesat për plotësimin e mangësive ose për sqarime gjatë shqyrtimit bëhen me shkrim, me afat të përcaktuar dhe me trajtim të njëjtë të rasteve të njëjta. Lejohen vetëm plotësimet që pranohen nga VKM-ja për FMF-në dhe dokumentet e konkurrimit; ato nuk mund të krijojnë pas afatit një kusht kualifikimi që mungonte ose të ndryshojnë përmbajtjen konkurruese të ofertës. Mospërgjigjja brenda afatit dhe pasojat e saj dokumentohen në vlerësim.

Neni 8

Dokumentacioni dhe kriteret e pranueshmërisë

1. Aplikuesi paraqet dokumentacionin që kërkohet nga VKM-ja për FMF-në dhe ftesa e konkurrimit, përfshirë, sipas rastit: të dhënat e regjistrit tregtar; licencën e vlefshme të furnizimit; të dhëna financiare; kapacitetet teknike dhe njerëzore; përvojën në furnizim; sistemet e faturimit dhe administrimit të klientëve; përmbushjen e detyrimeve fiskale dhe deklarimet për pengesa ligjore.

2. Kërkesat për vitet e përvojës, numrin e kontratave, kohëzgjatjen e licencës dhe garancinë e ofertës përcaktohen vetëm nëse dhe sipas masës që lejon VKM-ja për FMF-në.

3. Dokumentacioni kërkohet proporcionalisht me objektin e shërbimit dhe pa krijuar kufizime të pajustifikuara të konkurrencës.

4. Dokumentet e konkurrimit paraqesin veçmas kushtet minimale të kualifikimit dhe kriteret e pikëzimit. Për çdo kusht kualifikimi përcaktohen kërkesa, dokumenti provues, periudha që mbulon dhe mënyra e verifikimit. Kualifikimi vlerësohet me rezultatin "plotëson" ose "nuk plotëson".

5. Komisioni dokumenton me procesverbal për çdo aplikues përmbushjen ose mospërmbushjen e secilit kusht dhe arsyet përkatëse. Skualifikimi arsyetohet me referim te kërkesa e shpallur dhe te dokumentacioni i administruar. Rezultati i kualifikimit dhe njoftimi përkatës trajtohen sipas procedurës dhe afateve të ankimit të zbatueshme.

Neni 9

Aftësia për ushtrimin e shërbimit

1. Në vlerësim shqyrtohet aftësia e aplikuesit për të siguruar energjinë e nevojshme, për të menaxhuar kalimin e klientëve, për të përpunuar të dhënat e matjes, për të faturuar dhe për të trajtuar ankesat.

2. Shqyrtohet gjithashtu kapaciteti financiar për përballimin e furnizimit pa cenuar detyrimet ekzistuese ndaj klientëve të tjerë.

3. Kushtet minimale të pranimit dhe çdo kërkesë shtesë zbatohen në përputhje me VKM-në për FMF-në.

4. Aftësia për kryerjen e shërbimit provohet, sipas kërkesave të shpallura, me planin e sigurimit të energjisë, burimet dhe instrumentet e financimit, organizimin e personelit, kapacitetet e sistemeve të matjes e faturimit dhe planin e marrjes në administrim të klientëve. Dokumentet e konkurrimit përcaktojnë për secilin element provat e kërkuara dhe mënyrën e verifikimit, në raport me shtrirjen e shërbimit.

Neni 10

Vlerësimi dhe renditja

1. Komisioni vlerëson ofertat e kualifikuara sipas kritereve konkurruese, transparente dhe jodiskriminuese, në përputhje me nenin 110, pika 1, VKM-në për FMF-në dhe kriteret e shpallura paraprakisht.

2. Kriteret mund të përfshijnë aftësinë teknike dhe organizative, qëndrueshmërinë financiare, kushtet e pagesës, kostot e shërbimit dhe elementet ekonomike të ofertës, vetëm për aq sa parashikohen ose lejohen nga VKM-ja për FMF-në.

3. Dokumentet e konkurrimit përcaktojnë nëse marzhi i fitimit është kriter ekonomik i vetëm, pjesë e pikëzimit ose kriter për zgjidhjen e barazimit të ofertave, vetëm sipas modelit të lejuar nga VKM-ja për FMF-në. Kur përdoret pikëzimi, përcaktohen paraprakisht pikët maksimale dhe formula e llogaritjes për secilin kriter, si dhe mënyra e llogaritjes së rezultatit përfundimtar.

4. Për ofertat me pikë të barabarta përdoret mekanizmi i përcaktuar në VKM-në për FMF-në dhe në dokumentet e konkurrimit.

5. Përmbushja e një kushti minimal kualifikimi nuk vlerësohet vetvetiu me pikë. Kapacitetet mbi minimumin vlerësohen me pikë vetëm kur dokumentet e konkurrimit e parashikojnë shprehimisht, përcaktojnë mënyrën e matjes dhe kjo lejohet nga VKM-ja për FMF-në. I njëjti element nuk pikëzohet dy herë nën kritere të ndryshme.

6. Sqarimet gjatë vlerësimit nuk përdoren për të ndryshuar kriteret ose propozimin ekonomik të aplikuesit. Për çdo ofertë mbahet fleta e vlerësimit me pikët sipas kriterit, llogaritjet dhe arsyetimin përkatës. Zgjidhja e barazimit të ofertave dokumentohet në procesverbal dhe u komunikohet pjesëmarrësve.

Neni 11

Propozimi dhe vendimmarrja

1. Komisioni harton raportin e vlerësimit me dokumentimin e verifikimeve, pikëzimit dhe arsyetimit për renditjen e aplikuesve.

2. Raporti i komisionit i paraqitet Bordit të ERE-s për vendimmarrje, në përputhje me nenin 110, pika 2, të ligjit nr. 59/2026.

3. Bordi i ERE-s merr vendimin për caktimin e FMF-së për një periudhë trevjeçare, duke respektuar nenin 110, pikat 2 dhe 3, dhe kushtet e VKM-së për FMF-në.

4. Vendimi dhe njoftimet publikohen e komunikohen sipas ligjit dhe VKM-së për FMF-në.

5. Raporti përfundimtar përmban listën e aplikimeve, kërkesat për sqarime të administruara gjatë procesit dhe përgjigjet, rezultatet e kualifikimit, raportet e vlerësimit, renditjen dhe propozimin e arsyetuar. Bordi, kur konstaton nevojë për verifikime plotësuese, kërkon plotësimin e raportit pa ndryshuar kriteret e shpallura dhe pa lejuar riformulimin e ofertave.

6. Kur nuk paraqitet asnjë aplikim ose nuk kualifikohet asnjë aplikues, komisioni dokumenton rezultatin dhe i propozon Bordit përfundimin e procedurës pa caktim fituesi. Kur paraqitet ose kualifikohet vetëm një aplikues, vazhdimi dhe caktimi i FMF lejohen vetëm sipas kushteve të VKM-së për FMF-në; numri i aplikuesve nuk përjashton verifikimin e plotë të kushteve dhe ofertës.

7. Vendimi i caktimit të një FMF-je përcakton datën e fillimit dhe mbarimit të periudhës trevjeçare, detyrimet për marrjen e shërbimit dhe koordinimin e kalimit nga FMF-ja ekzistuese. Marrja e shërbimit dokumentohet me procesverbal ndërmjet subjekteve përgjegjëse, sipas detyrave të secilit dhe rregullave të zbatueshme.

Neni 12

Të drejtat dhe detyrimet gjatë furnizimit

1. FMF ushtron veprimtarinë në përputhje me ligjin nr. 59/2026, kushtet e licencës, VKM-në për FMF-në, kushtet kontraktore dhe aktet e ERE-s të zbatueshme për furnizimin e mundësisë së fundit.

2. FMF informon pa vonesë ERE-në dhe autoritetet e tjera kompetente për rrezikun e pamundësisë së përmbushjes së shërbimit.

3. Informimi i klientëve, faturimi, ankesat, ndryshimi i furnizuesit dhe mbrojtja e të dhënave personale realizohen sipas legjislacionit dhe akteve rregullatore në fuqi.

4. Çmimi i furnizimit nga FMF përcaktohet nga ERE sipas metodologjisë së miratuar prej saj, në përputhje me nenin 110, pika 4, dhe nenin 21 të ligjit nr. 59/2026.

Neni 13

Monitorimi dhe mbikëqyrja

1. ERE monitoron respektimin e detyrimeve të të licencuarit të ngarkuar me furnizimin e mundësisë së fundit, brenda kompetencave të saj ligjore.

2. FMF i paraqet ERE-s të dhënat dhe raportimet e kërkuara sipas ligjit, licencës, VKM-së për FMF-në dhe akteve rregullatore përkatëse.

3. Raportimet përfshijnë, sipas objektit të kërkesës së ERE-s, numrin e klientëve dhe lëvizjet drejt e nga FMF-ja, energjinë e furnizuar, çmimet e aplikuara, faturimin, ankesat, problematikat e transferimit dhe treguesit e aftësisë për të vijuar shërbimin. Periodiciteti, formati dhe afati i raportimit përcaktohen në vendimin e caktimit ose në aktin përkatës të ERE-s dhe i komunikohen FMF-së. Detyrimi për njoftimin e rrezikut të pamundësisë së shërbimit përmbushet pa pritur raportimin periodik.

Neni 14

Ankimi dhe rishikimi

1. Njoftimi i skualifikimit identifikon rezultatin e verifikimit, kërkesat e paplotësuara dhe arsyet përkatëse. Njoftimi dhe vendimi përfundimtar përmbajnë informacion për aktin që mund të kundërshtohet, organin ku paraqitet kundërshtimi dhe afatin ligjor. Komisioni dokumenton kualifikimin; kompetenca për vendimmarrjen përkatëse dhe njoftimi ushtrohen sipas VKM-së për FMF-në dhe legjislacionit në fuqi.

2. Rishikimi administrativ dhe ankimi gjyqësor ushtrohen sipas legjislacionit në fuqi, duke respektuar procedurat e posaçme që përcaktohen nga VKM-ja për FMF-në.

Neni 15

Dispozita kalimtare dhe hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Procedura e përzgjedhjes sipas neneve 4–11 dhe anekseve fillon të zbatohet pas hyrjes në fuqi të VKM-së për FMF-në dhe miratimit të dokumenteve të konkurrimit në përputhje me të. Dispozitat për shërbimin, transferimin dhe monitorimin zbatohen në përputhje me regjimin kalimtar të ligjit dhe aktet e shërbimit në fuqi, pa krijuar ndërprerje të funksioneve ekzistuese.

2. Vendimi miratues i Bordit përcakton shprehimisht shfuqizimin e rregullores së miratuar me vendimin nr. 141, datë 15.06.2021, dhe datën e efektit të tij. Kjo datë lidhet me fillimin e zbatimit të procedurës së re, duke ruajtur të drejtat dhe detyrimet ekzistuese sipas nenit 135 të ligjit nr. 59/2026. Për procedurat e nisura përpara kësaj date, vendimi miratues përcakton rregullat kalimtare të zbatueshme.

Formular aplikimi për përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit

Kërkesë: Për pjesëmarrjen në procedurën e përzgjedhjes së FMF dhe paraqesim aplikimin me dokumentacionin provues dhe ofertën sipas kërkesave të shpallura.

1. Identifikimi i procedurës

E dhëna	**Plotësohet nga aplikuesi**
Referenca dhe data e ftesës	_____
Vendimi i fillimit të procedurës	
Objekti dhe shtrirja e shërbimit	_____
Data e aplikimit	_____

2. Të dhënat e aplikuesit

E dhëna	**Plotësohet nga aplikuesi**
Emërtimi dhe forma ligjore	_____
NUIS / numri i regjistrimit	_____
Selia dhe adresa elektronike korrespondencës	_____
Përfaqësuesi ligjor dhe funksioni	_____
Përfaqësuesi i autorizuar dhe akti i autorizimit	_____
Personi i kontaktit dhe funksioni	_____
Telefoni dhe adresa elektronike	_____
Licenca e furnizimit, vendimi dhe afati	_____

3. Përmbushja e kushteve të kualifikimit

Për çdo kusht të ftesës shënohet referenca e saktë dhe dokumenti provues. Vetëdeklarimi nuk zëvendëson dokumentin kur ai kërkohet shprehimisht. Shtohen rreshta sipas numrit të kushteve të shpallura.

Referenca dhe kushti i ftesës	**Dokumenti provues dhe periudha**	**Nr. i aneksit dhe faqja**
_____ _____	_____ _____	_____
_____ _____	_____ _____	_____

Referenca dhe kushti i ftesës	Dokumenti provues dhe periudha	Nr. i aneksit dhe faqja
_____ _____	_____ _____	_____
_____ _____	_____ _____	_____
_____ _____	_____ _____	_____

4. Kapaciteti financiar dhe sigurimi i energjisë

Të dhënat paraqiten për periudhat dhe në njësitë e kërkuara në ftesë, pa vendosur periudha ose pragje të tjera nëpërmjet këtij formulari.

Treguesi sipas ftesës	Periudha dhe vlera me njësi	Dokumenti dhe aneksi
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

Burimet dhe instrumentet e financimit për shërbimin e FMF-së, vlera, afati dhe dokumentet provuese

_____

_____

Mënyra e përballimit të furnizimit pa cenuar detyrimet ekzistuese ndaj klientëve të tjerë

_____

_____

Plani i sigurimit të energjisë, burimet e parashikuara dhe referenca e aneksit përkatës

_____

_____

Për garancinë e ofertës, vetëm kur kërkohet: lloji _____; institucioni lëshues _____; numri _____; vlera dhe monedha _____; vlefshmëria _____; aneksi _____.

5. Oferta teknike dhe organizimi i shërbimit

Përshkrimet e hollësishme paraqiten në anekse të veçanta. Këtu jepet përmbledhja dhe referenca e tyre; sasia dhe njësia shënohen për elementet e matshme të kërkuara në ftesë.

Përvoja në furnizim dhe kontratat përkatëse, për periudhën e kërkuar në ftesë; referenca e dokumenteve provuese

_____

_____

Organizimi i personelit dhe përgjegjësitë për furnizimin, matjen, faturimin, klientët dhe ankesat; aneksi

_____

_____

Sistemet për marrjen, verifikimin dhe përpunimin e të dhënave të matjes; aneksi

_____

_____

Sistemet e faturimit, administrimit të klientëve dhe mbrojtjes së të dhënave; aneksi

_____

_____

Kanalet e komunikimit, informimi i klientëve dhe trajtimi i ankesave; aneksi

_____

_____

6. Plani i marrjes së shërbimit

Veprimi dhe rezultati i parashikuar	**Përgjegjësi dhe koordinimi**	**Afati nga marrja e shërbimit**
Identifikimi i klientëve dhe shkëmbimi i të dhënave	_____	_____
Verifikimi i leximeve dhe fillimi i faturimit	_____	_____
Informimi i klientëve dhe administrimi i kalimeve	_____	_____
Masat për vijimësinë e furnizimit dhe raportimin	_____	_____

Referenca e planit të plotë dhe aneksit: _____

7. Oferta ekonomike

Plotësohet vetëm sipas modelit ekonomik, njësive dhe elementeve të kërkuara nga dokumentet e konkurrimit. Çmimi i rregulluar i furnizimit nga FMF-ja nuk përcaktohet nga aplikuesi në këtë formular.

Referenca e kërkesës ekonomike dhe mënyra e shprehjes së ofertës sipas ftesës

_____

Elementi ekonomik i kërkuar	**Vlera në shifra dhe njësia**	**Vlera me fjalë**
Marzhi i fitimit, vetëm nëse kërkohet	_____	_____

Elementi ekonomik i kërkuar	Vlera në shifra dhe njësia	Vlera me fjalë
Kosto shërbimi, vetëm nëse kërkohet	_____	_____
Element tjetër sipas ftesës: _____	_____	_____
Element tjetër sipas ftesës: _____	_____	_____

Baza e llogaritjes së marzhit ose kostos dhe përbërësit e përfshirë, sipas ftesës

_____

_____

Monedha: _____ Trajtimi i TVSH-së sipas ftesës: _____

Kushtet e pagesës, kur kërkohen si element i ofertës

_____

_____

Vlefshmëria e ofertës sipas ftesës: nga ____ / ____ / _____ deri më ____ / ____ / _____, ose për _____ ditë nga data e përcaktuar në dokumentet e konkurrimit.

Referenca e aneksit ekonomik dhe e llogaritjeve mbështetëse

_____

8. Përgjigjja ndaj kritereve të vlerësimit

Aplikuesi referon elementet e ofertës që provojnë secilin kriter të shpallur; pikët caktohen nga komisioni. Kjo rubrikë nuk përdoret për shtimin e kritereve të reja.

Kriteri dhe referenca e ftesës	Elementi i ofruar dhe vlera e matshme	Aneksi dhe faqja
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

9. Inventari i dokumenteve bashkëlidhur

Për çdo dokument shënohet numri i aneksit dhe faqet. Lista përdoret sipas kërkesave të ftesës; për dokumentet që nuk kërkohen shënohet “Nuk kërkohet”.

Dokumenti ose grupi i dokumenteve	Aneksi dhe faqet
Dokumentacioni i regjistrimit tregtar	_____
Licenca e vlefshme e furnizimit	_____
Autorizimi i përfaqësuesit, kur zbatohet	_____
Dokumentet financiare dhe burimet e financimit	_____

Dokumenti ose grupi i dokumenteve	Aneksi dhe faqet
Provat e përvojës në furnizim	_____
Dokumentet për personelin dhe sistemet teknike	_____
Plani i sigurimit të energjisë dhe marrjes së shërbimit	_____
Dokumentet fiskale dhe deklarimet për pengesa ligjore	_____
Oferta ekonomike dhe llogaritjet mbështetëse	_____
Garancia e ofertës, vetëm kur kërkohet	_____
Dokumente të tjera sipas ftesës: _____	_____

10. Deklarimi dhe nënshkrimi

Unë, _____, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor / të autorizuar të _____, deklaroj se të dhënat e këtij aplikimi dhe dokumentet e paraqitura janë të sakta dhe të plota sipas dijenisë sime dhe se jam i autorizuar ta nënshkruaj aplikimin.

Deklaroj se kemi shqyrtuar ftesën dhe dokumentet e konkurrimit, përfshirë sqarimet e publikuara, dhe se oferta është përgatitur sipas tyre. Deklarimet për pengesat ligjore dhe përmbushjen e detyrimeve paraqiten në përmbajtjen dhe formën e kërkuar në dokumentet e konkurrimit. Marrim përsipër të japim sqarimet e kërkuara brenda afateve dhe kufijve të procedurës.

Në rast përzgjedhjeje, marrim përsipër ushtrimin e shërbimit sipas vendimit të caktimit, kushteve të licencës dhe akteve të zbatueshme.

Vendi dhe data: _____

Emri dhe funksioni: _____

Nënshkrimi: _____ Vula, kur kërkohet: _____